



Republika e Kosovës
Republic Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtine
Opština Pristine –Municipality of Prishtine



Drejtoria e Financave

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2022-2024

Faqe 1 nga 46

Përmbajtja

Korniza afatmesme buxhetore komunale.....	3
Objektivat e Kornizës afatmesme buxhetore komunale	4
Objektivat e Komunës së Prishtinës	4
Objektivat e Qeverisë së Kosovës.....	4
Objektivat dhe përfitimet e procesit të KAB-së për komunat	5
Objektivat.....	5
Struktura organizative e Komunës së Prishtinës	7
Programet	8
Pjesëmarrja e programeve buxhetore në grantin qeveritar 2024 -2024.....	9
Perspektiva e politikave fiskale	10
Pjesëmarrja e granteve në buxhet, sipas viteve, 2022 – 2024.....	10
Parashikimi i të hyrave vetanake komunale.....	11
Plani i të hyrave vetanake komunale 2022 – 2024	11
Vlerësimet e hershme të shpenzimeve të programeve buxhetore.....	15
Grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake 2022 – 2024	17
Buxheti 2022-2024 dhe deklaratat e misioneve dhe vizioneve sipas programeve buxhetore - drejtorive.....	18

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2022 - 2024

Korniza afatmesme buxhetore komunale e Komunës së Prishtinës, është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, që do të pasqyrojë caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me Strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Si pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB), është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2022/2024, të dhëna nga Ministria e Financave (MF), përmes Qarkores buxhetore 2022/01 për komunat, si dhe financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë të buxhetit komunal për vitin 2022 dhe parashikimet për periudhën 2023 - 2024, që janë miratuar nga Komisioni i granteve, si pjesë integrale e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) 2022 – 2024, e miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15 maj 2021.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare. Me Kornizën afatmesme buxhetore – komunale, do t'i paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prishtinës, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën, me të cilën buxheti i Komunës do t'i përmbushë dhe përkrahë projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2022 – 2024, gjithnjë duke u bazuar në:

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë dhe
- Ligjin e buxhetit.

OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2022 – 2024, planifikohet në bazë të Buxhetit, i cili bazohet në Buxhetin e programeve dhe është i bazuar në objektivat dhe në deklaratat e misioneve të programeve. KAB-ja komunale 2022–2024, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore nr. 2022/02, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Në KAB-në komunale paraqiten edhe deklaratat dhe misionet e drejtorive lidhur me punën e tyre pasuese trevjeçare.

❖ Objektivat e Komunës së Prishtinës:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit;
- Menaxhimi i arkëtimit të mbeturinave, duke ndihmuar ndërmarrjen publike për pastrim;
- Hartimi i planit zhvillimor komunal dhe planeve rregulluese në zonat urbane;
- Zhvillimi i fushës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Përfshirja e tërësishme në arsim parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit;
- Zhvillimi i fushës së kulturës, rinisë dhe sportit;
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Përkrahja e të rinjve dhe ulja e papunësisë;
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Përkrahja e OJQ-ve në përgjithësi, e në veçanti organizatat e të rinjve.

❖ Objektivat e Qeverisë së Kosovës:

- Rritja dhe qëndrueshmëria ekonomike;
- Punësimi dhe mirëqenia;
- Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
- Integritet evropiane, politika e jashtme dhe çështjet e sigurisë;
- Arsimi, shkenca, kultura, rinia dhe sporti;
- Shëndetësia moderne.

❖ **Objektivat dhe përfitimet e procesit të KAB-së për komunitat**

Inkorporimi i qasjes së KAB-së në proceset e buxhetit komunal, është i motivuar nga qëllimet e mëposhtme:

- Të ofrojë kornizë gjithëpërfshirëse dhe reale për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme;
- Të rrisë parashikimin dhe qëndrueshmërinë e planifikimit të buxhetit, përmes futjes së parashikimit më të besueshëm të të hyrave komunale dhe shpenzimeve në perspektivë trevjeçare;
- Të përmirësojë lidhjen në mes procesit të alokimit të burimeve dhe prioritetëve të politikave komunale;
- Të fuqizohen drejtoritë komunale në shpërndarjen e burimeve, menaxhim dhe shfrytëzim;
- Të bëhet planifikimi sa më objektiv nëpër kategori ekonomike – BDMS;
- Të bëhet alokimi i mjeteve buxhetore për vitet e ardhshme sipas kategorive ekonomike;
- Planifikimi i investimeve kapitale përmes sistemit të PIP-së;
- Përfshirja e buxhetit gjinor në të gjitha fushat, si një implementim i nevojshëm për të garantuar parimin e barazisë gjinore.

Objektivat:

a) Shtimi i efikasitetit dhe efektivitetit:

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;
- Planifikimi i buxhetit në kode dhe nënkode ekonomike;
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur dhe cilësore;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim.

b) Kritja e të hyrave vetanake:

- Kritja e efikasitetit në arkëtim;
- Mundësia për implementimin e tarifave të reja.

c) Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Përmirësimi i performancës për mallra dhe shërbime;
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat kornizë.

d) Ngritja e kapaciteteve njerëzore

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore;
- Përdorim i software-ve të avancuar për shërbime;
- Profesionalizimi i shërbimeve .

e) Sigurimi i disiplinës financiare:

- Harmonizim me politikat financiare, ligjet, rregulloret dhe me udhëzimet administrative;
- Ekzistenca e kontrolleve interne – auditori i brendshëm dhe implementimi i rekomandimeve;
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik;
- Analiza të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve;
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh plani);
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas programit të BDMS – SZHMB;
- Planifikimi dhe realizimi investimeve kapitale sipas programit të PIP-së (Programi i investimeve publike);
- Respektimi i Ligjit të buxhetit - mos hyrja në obligime pa mbulesë - zotim të mjeteve.

f) Ekonomia:

- Zhvillimi i Strategjisë komunale për promovim ekonomik;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- Strategjia për zhvillimin rural;
- Strategjia për biodiversitet;
- Menaxhimi i mbeturinave.

Struktura organizative e Komunës së Prishtinës

616	KOMUNA E PRISHTINES	
1.1	160	Zyra e Kryetarit
1.1.1	16006	Zyra e Kryetarit
1.2	169	Zyra e Kuvendit të Komunës
1.2.1	16906	Zyra e Kuvendit të Komunës
1.3	163	Administrata dhe Personeli
1.3.1	16306	Administrata
1.4	166	Inspektimet
1.4.1	16611	Inspektimet
1.5	167	Prokurimi
1.5.1	16730	Prokurimi
1.6	175	Buxheti dhe financat
1.6.1	17506	Buxheti
1.6.2	17581	Tatimi ne Prona
1.7	180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca
1.7.1	18040	Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave
1.7.2	18166	Infrastruktura publike
1.7.3	18230	Zjarrfikësit dhe inspektimet
1.7.4	18039	Menaxhimi i parqeve
1.8	195	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
1.9	470	Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural
1.9.1	47006	Bujqësia
1.10	480	Zhvillimi ekonomik
1.10.1	48006	Planifikimi i zhvillimit ekonomik
1.11	650	Kadastrri dhe gjeodezia
1.11.1	65030	Shërbimet kadastrale
1.12	660	Planifikimi urban dhe mjedisi
1.12.1	66335	Planifikimi urban dhe inspeksioni
1.13	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale
1.13.1	73015	Administrata

1.13.2	73350		Shërbimet e shëndetësisë primare
1.14	755		Shërbimet sociale
1.14.1	75525		Shërbimet sociale
1.15	850		Kultura, rinia dhe sportet
1.15.1	85006		Shërbimet kulturore
1.15.2	85086		Sporti dhe rekreacioni
1.16	920		Arsimi dhe shkenca
1.16.1	92030		Administrata
1.16.2	92310		Arsimi parashkollor dhe çerdhet
1.16.3	93150		Arsimi fillor
1.16.4	94350		Arsimi i mesëm

Programet:

a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparencë:

- Respektimi i procedurave të prokurimit;
- Evidenca e duhur financiare dhe procedurat e kontabilitetit;
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës;
- Koordinimet në mes drejtorive – programeve buxhetore;
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Informimi publik.

b. Përmirësimi i bazës së të hyrave vetanake komunale:

- Rritja e performancës së arkëtimit të tarifave dhe taksave komunale;
- Regjistrimi i tatimpaguesve të rinj për tatimin në pronë;
- Tarifa (ngarkesa) të reja për shërbime të reja;
- Tarifa (taksa) ekonomikisht të arsyetuara;
- Ngarkesa të reduktuara (periodike).

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:

- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve tjera;

- Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje;
- Zbatimi dhe respektimi i rregulloreve komunale;
- Shqyrtimi i Planit të punës 2021;
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës për vitin 2022;
- Përgatitja e Kornizës afatmesme buxhetore 2022-2024;
- Përgatitja e qarkoreve interne komunale;
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore me qytetarë;
- Përgatitja e planeve rregulluese dhe detaje;
- Përmirësimi i mbledhjes bazike të të dhënave dhe analiza e tyre;
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe i obligimeve komunale;
- Menaxhimi i projekteve;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Monitorimi;
- Vlerësimi;


1.1. Korniza makroekonomike

Korniza makroekonomike është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas kritereve të Kornizës afatmesme buxhetore (KAB).

Pjesëmarrja e programeve buxhetore në totalin e grantit qeveritar 2022.

Komuna	Granti i përgjithshëm	Granti specifik për Arsim	Granti specifik për Shëndetësi	Ligji për Kryeqytet	Të hyrat vetjake	Gjithsej financimi 2021
Prishtinë	19,640,612	21,972,910	6,950,006	11,611,800	30,494,005	90,669,333

Buxheti për vitin 2021



2. Pjesëmarrja e granteve në totalin e buxhetit, sipas viteve 2022 – 2024

2.1. Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale, politikës së të ardhurave, si nga granti i Qeverisë, të hyrave vetanake komunale dhe shpenzimeve. Me Kornizën afatmesme buxhetore 2022 – 2024, e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15.05.2021, bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe Kornizës makrofikale për 2022 -2024, Qeveria është përkushtuar që duke e ruajtur stabilitetin fiskal, të përkrahë edhe kërkesat e organizatave buxhetore, duke paraparë ndërmarrjen e një varg masash, që nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve operative – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së ¹, e deri te marrja e masave konkrete në realizimin e të hyrave në nivel qendror dhe lokal, si:

- Kontroll më efikas dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifatat e mbledhura në nivel lokal;

- Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës;
- Zyrat komunale të tatimit në pronë, udhëzohen të bëjnë rekomandimet e tyre në vendosjen e zonave të vlerësimit të normave tatimore, nivelin e përpjekjeve në mbledhjen e tatimit në pronë, me qëllim të arritjes së të hyrave të planifikuara të tatimit në pronë të paraparë me projektbuxhet.

Parashikimi i të hyrave vetanake të Komunës së Prishtinës për periudhën 2022-2024

Të hyrat komunale të Komunës së Prishtinës realizohen në bazë të Ligjit mbi financat e pushtetit lokal, Rregullores mbi tarifrat dhe ngarkesat komunale, Rregullores mbi tatimin në pronë, si dhe dispozitave tjera ligjore, të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat Komuna ka të drejtë të caktojë dhe arkëtojë të hyra të tjera komunale.


Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë tatimi në pronë dhe të hyrat nga lejet e ndërtimit, të cilat të hyra duhet shpenzuar, dhe ekskluzivisht dedikohen në fushën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime të tjera, gjë që ju kthehen qytetarëve (tatim paguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës publike komunale. Nga viti 2019, edhe përmes Qarkores buxhetore 2019/01, parashikohet që të fillojë arkëtimi i tatimit në tokë.

Të hyrat e Komunës për periudhën 2022-2024, parashihet të arkëtohen nga:

- Tatimi në pronë,
- Tatimi në tokë,
- Taksa për mbeturina,
- Taksa për leje ndërtimi,
- Taksa administrative komunale,
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste,
- Taksat për lejen për shërbime profesionale,
- Taksa për automjete motorike,
- Taksa për certifikata,
- Qiraja nga objektet,
- Participim në Arsim,
- Participim në Shëndetësi,
- Qiraja e tokës.

KOMUNA	Taksat, ngarkesat dhe të hyrat tjera jo tatimore	Të hyrat nga tatimi në pronë	Projeksionet për vitin 2021
PRISHTINË	19,779,026	10,714,979	30,494,005

TE HYRAT VETANAKE TE KOMUNES SE PRISHTINES PËR VITIN 2020





■ Taksat, ngarkesat dhe të hyrat tjera jo tatimore ■ Të hyrat nga tatimi në pronë

Taksa komunale për leje ndërtimi, është gjithashtu një kategori e rëndësishme e të hyrave. Gjatë planifikimit të kësaj të hyre, Komuna ende nuk është e sigurt me gjendjen e legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje. Të gjitha objektet që nuk janë të legalizuara, por janë pjesë e planit urban, do të legalizohen. Presim që me miratimin e Ligjit mbi tatimin në tokë, gjatë vitit 2022, të rritet arkëtimi i THV-së.

Me qëllim të rritjes së të hyrave vetanake, Komuna do të formojë një ekip për ngritjen e performancës së të hyrave vetanake për vitet e ardhshme.

Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2022 - 2024

Nr.	PËRSHKRIMI	2022	2023	2024
1	Taksa për leje ndërtimi	6,800,000.00	6,882,000.00	7,000,000.00
2	Legalizimi i ndertimeve pa leje	200,000.00	200,000.00	200,000.00
3	Leje mjedisore komunale	700,000.00	800,000.00	900,000.00
4	Tatimi në pronën e paluajtshme dhe tokë	10,714,979.00	11,385,422.00	12,046,204.00
5	Menaxhimi i mbeturinave	4,338,000.00	4,338,000.00	4,338,000.00
6	Licenca në biznes	150,000.00	200,000.00	250,000.00
7	Taksa për shfrytëzimi i sip. publike	150,000.00	200,000.00	250,000.00
8	Konfiskimi i veturave - me merimangë	70,000.00	100,000.00	150,000.00
9	Infrastrukturë rrugore	2,564,122.00	2,670,023.00	2,750,568.00
10	Taksa nga kadastri dhe gjeodezia	850,000.00	900,000.00	950,000.00
11	Taksa për transakcion në pronë	700,000.00	750,000.00	800,000.00
12	Të hyra nga inspekcioni	150,000.00	150,000.00	150,000.00
13	Taksa për certif.dhe doku.zyrtare	221,904.00	252,373.00	280,000.00
14	Taksa për automjete motorrike	700,000.00	730,000.00	750,000.00
15	Taksa për shërbime arsimore	700,000.00	700,000.00	700,000.00
16	Bibloteka dhe teatri "Dodona"	15,000.00	15,000.00	15,000.00
17	Taksa për shërbime shëndetësore	300,000.00	300,000.00	300,000.00
18	Qiraja	40,000.00	40,000.00	40,000.00
19	Hortikultura	200,000.00	210,000.00	220,000.00
20	Të hyrat tjera (Konf.tenderi)	15,000.00	15,000.00	15,000.00
21	Shitja e pasurisë	15,000.00	20,000.00	25,000.00
22	Shpronsime	900,000.00	900,000.00	900,000.00
	Gjithsej	30,494,005.00	31,757,818.00	33,029,772.00



➤ Vlerësimet e hershme të shpenzimeve të programeve buxhetore

Në vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore përfshihen, kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor, duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal, dhe duke pasur për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2021 dhe shpenzimet gjatë viteve të fundit. Kjo kornizë paraqet parashikimin trevjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale.

Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit, si dhe të granteve të Qeverisë, të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve buxhetore dhe limiteve të buxhetit, të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i granteve të MF-së.

Tabela 3: Planifikimi i shpenzimeve për Komunën e Prishtinës (2022-2024)

Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme	
	2021	2022	2023	2024
Paga dhe mëditje	31,000,000	31,300,000	31,456,500	31,241,264
Mallra dhe shërbime	20,100,000	21,198,930	21,903,297	20,596,879
Shpenzime komunale	2,100,000	2,200,000	2,256,807	2,221,893
Subvencione dhe transfere	4,000,000	4,786,215	5,186,829	4,513,375
Investime kapitale	28,592,836	31,184,188	33,974,817	39,517,544
Gjithsej	85,792,836	90,669,333	94,778,250	99,155,560

Grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake komunale 2022 - 2024

Më poshtë janë paraqitur granti i përgjithshëm, granti specifik i Arsimit, granti specifik për Shëndetësi, dhe plani i të hyrave vetanake komunale sipas viteve 2022 – 2024.

Tabela 1: Vlerësimet e burimeve të financimit për Komunën e Prishtinës (2022-2024)

Burimet e financimit	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme ²	
	2021	2022	2023	2024
Granti i përgjithshëm	18,508,057	19,640,612	20,525,970	21,530,273
Granti specifik për Shëndetësi	6,950,006	6,950,006	7,297,506	7,662,382
Granti specifik për Arsim	21,108,027	21,972,910	23,071,555	24,225,133
Granti specifik për kryeqytetin	10,954,800	11,611,800	12,125,400	12,708,000
Të hyrat vetjake	28,271,946	30,494,005	31,757,818	33,029,772
Gjithsej	85,792,836	90,669,333	94,778,249	99,155,560

ZYRA E KRYETARIT

Kryetar: Z. Shpend Ahmeti

Zyra e Kryetarit

Deklarata e misionit: Realizon mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të Komunës, kujdeset për zbatimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson Komunën, zbaton të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të Komunës, përgatit propozime për çështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të Komunës.

Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e LVL-së dhe Statutit të Komunës, është përgjegjës të:

1. përfaqësojë Komunën dhe të veprojë në emër të saj;
2. udhëheqë ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj, dhe të mbikëqyrë administrimin financiar të Komunës;
3. ushtrojë të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
4. ekzekutojë aktet e Kuvendit të Komunës;
5. emërojë dhe shkarkojë zëvendësin e tij/saj;
6. emërojë dhe shkarkojë drejtorët, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
7. organizojë punën dhe të drejtojë politikën e Komunës;
8. propozojë rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
9. propozojë zhvillimin komunal, planet rregulluese dhe investuese, të propozojë buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe të ekzekutojë buxhetin e miratuar;
10. raportojë para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike – financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku një herë në gjashtë muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës;
11. kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsiderohet se akti bie në kundërshtim me legjislacionin në zbatimin, apo interesin e komuniteteve;
12. mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm financiar;
13. delegojë përgjegjësi te anëtarët e Këshillit të Drejtorëve dhe të mbikëqyrë zbatimin e përgjegjësisive të deleguara.

NR.	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	330,000	330,000	330,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	330,000	330,000	330,000

	Stafi	45	45	45
--	--------------	-----------	-----------	-----------

Nënkryetarë: Z. Selim Pacolli dhe z. Muhedin Nushi

Deklarata e misionit: Organizon koordinimin e punës me komitetet e fshatrave dhe bashkësive, mbikëqyrë marrëdhëniet me publikun, koordinon oraret me mediat elektronike dhe të shkruara, zëvendëson kryetarin në rast të mungesës së tij.

Spektori i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga tre auditorë. Kjo njësi gjatë vitit fiskal, kryen auditime nëpër drejtoritë komunale. NJAB-ja ka për mision të kontrollojnë ecurinë e punëve dhe shërbimeve të cilat ofrohen në organizatën tonë buxhetore. Qëllimi i tyre është që të ngrihet niveli i performancës së Komunes.

Në kuadër të misionit të saj, Njësia e auditimit të brendshëm:

- siguron zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregulloreve, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve;
- siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të planeve për auditim të brendshëm;
- organizon, kryen dhe mbikëqyrë ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe dorëzon rezultatet e auditimit para Komisionit të auditimit;
- përgatit dhe dorëzon raporte tremujore dhe vjetore mbi të gjitha aktivitetet e auditimit të NJAB-së te Komisioni i auditimit;
- kryen auditime të brendshme në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale të nxjerra nga organet qendrore dhe lokale, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- shqyrton të gjitha të dhënat teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe informatat e dokumentit në posedim ose kontroll të subjektit në auditim;

- kopjon të dhënat, informatat apo dokumentet për qëllime të auditimit të brendshëm dhe siguron që kopjet në fjalë të jenë origjinale ose të vërtetuara;
- mund të kërkojë nga cilido zyrtar, punonjës, këshilltar që të ofrojë dëshmi fizike, shënime ose dëshmi gojore, ose informata të tjera mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditimin ose mbi aktivitetet që janë në auditim;
- ka qasje pa pengesë në stabilimentet e subjektit në auditim, dhe verifikon dhe vlerëson vlerat materiale dhe monetare të subjektit, në pajtim me rregullat dhe legjislacionin në fuqi;
- propozon masat që duhet të ndërmerren nga subjekti përkatës;
- merr informata të certifikuara nga Thesari, BPK-ja dhe cilado organizatë publike apo private në lidhje me xhirollogarinë aktuale apo të mbyllur;
- për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të Komunës;
- kryen edhe punë të parapara sipas ligjit, Statutit të Komunës së Prishtinës dhe rregulloreve në fuqi, si dhe vendimeve dhe urdhëresave të Kryetarit të Komunës.

Sektori i burimeve njerëzore

Sektori i burimeve njerëzore ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet ligjore që i përkasin, në funksion të zbatimit të kërkesave ligjore të dispozitave të Ligjit për shërbimin civil, Ligjit të punës dhe akteve të brendshme të Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka, bën:

- vlerësimin dhe miraton kërkesat për plotësimin e vendeve të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mundësitë buxhetore të Komunës;
- hartimin dhe shpalljen e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira, në përputhje me ligjin dhe procedurat në fuqi;
- propozimin e komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për plotësim të vendeve të lira, në përputhje me ligjin dhe procedurat;
- hartimin e vendimeve dhe formën e kontratave për kandidatët e përzgjedhur;
- inicimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësve civilë, në rastet e shkeljeve të detyrave të punës dhe shkeljeve të tjera të kodit të mirësjelljes, me kërkesë të zyrtarit kompetent;
- zbatimin e pezullimit parandalues, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- përkujdesje për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në kuadër të Komunës së Prishtinës, në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi;
- krijimin, kultivimin dhe ruan relacionet e bashkëpunimit me zyra dhe asociacione që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe obligimet e nëpunësve civilë dhe publikë;
- hartimin dhe kujdeset për evidencën e punëtorëve -shërbyesve civilë të drejtorive të administratës komunale, në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi;
- bashkëpunon me të gjitha drejtoritë komunale;
- kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Sektorit.

Njësia e personelit udhëhiqet nga udhëheqësi/menaxheri i Personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe procedurat për legjislacionin civil; Udhëheqësi/menaxheri i Personelit për punën e tij, i raporton Kryetarit të Komunës.

Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim evropian

Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe qytete, ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë dhe të drejtat dhe detyrimet ligjore dhe të kërkesave të Kryetarit të Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka, ky sektor:

- ofron mbështetje profesionale dhe teknike për Kryetarin e Komunës, në krijimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve me vende dhe qytete të vendeve të tjera;
- kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të vizitave zyrtare jashtë vendit;
- kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të pritjeve zyrtare brenda vendit;
- kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të takimeve dhe konferencave rajonale dhe ndërkombëtare, të iniciuara nga Komuna e Prishtinës;
- ofron informata dhe dokumente të nevojshme për aktivitetet ndërkombëtare të Kryetarit të Komunës;
- ruan, mirëmban dhe sistemon dokumentacionin mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të Komunës së Prishtinës me vende dhe qytete të vendeve të tjera;
- kujdeset për shkëmbimin e informacioneve, dhuratave dhe letërkëmbimeve të Kryetarit të Komunës me personalitet ndërkombëtare;
- përgatit materiale të nevojshme për nevojat e Komunës, për çështjet që lidhen me integrimet evropiane;
- hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE – së, që ofrojnë mbështetje për qeverisje dhe zhvillim lokal;
- kryen edhe punë të tjera, me kërkesë të Kryetarit të Komunës dhe në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Sektorit.

Sektori për politika publike,

Sektori për politika publike, ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet ligjore, si dhe kërkesat e Kryetarit të Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka:

- ofron mbështetje profesionale dhe teknike për Kryetarin e Komunës në fushën e politikave publike;
- koordinon dhe ofron mbështetje në formulimin e politikave publike lokale;
- ndërmerr aktivitete hulumtuese që ofrojnë informacion dhe analiza mbi politikat publike lokale, me kërkesë të Kryetarit të Komunës;
- organizon dhe përgatit tryeza diskutimi mbi politikat publike lokale.

Sektori për komunikim me publikun

Sektori për politika publike, ushtron kompetenca në përputhje me kërkesat e Kryetarit të Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka:

- merr pjesë në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës, brenda dhe jashtë Komunës;
- përcjellë mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve, të komiteteve dhe të Kuvendit të Komunës;
- koordinon ndërlidhjen me shtypin vendor dhe atë ndërkombëtar, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive dhe zyrave të tjera;
- koordinon zhvillimin dhe zbatimin e akteve komunale për komunikim me publikun;
- ofron informata për politikën e zhvillimit të Komunës;
- mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë për komunikim me qytetarë dhe administron Kodin e mirësjelljes së zyrtarëve për komunikim, për të mbajtur standarde të larta etike për zyrtarët për komunikim;
- siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtorëve të administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe mediave;
- informon publikun për vendimet që merr Kuvendi, me anë të konferencave dhe lëshimit të kumtesave për shtyp;
- mban lidhje me shtypin lokal dhe mediat elektronike për çështjet që u takojnë organeve të Komunës;
- është kompetente për publikimin e gazetës së brendshme “Buletini”, në nivel të Komunës;
- siguron informacione brenda Komunës dhe është në bashkëpunim të përhershëm me drejtorët e drejtorive dhe shërbyesit civilë të punësuar në drejtoritë e administratës;
- shoqëron përfaqësuesit e mediave brenda Komunës dhe regjistron deklaratat e zyrtarëve komunalë dhënë përfaqësuesve të mediave;
- përgatit fletëpalosje, buletin, broshura etj.;
- seleksionon dhe arkivon shkrimet e gazetave që kanë të bëjnë me Komunën;
- kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Prishtinës dhe me rregulloret tjera.

Sektori për të drejta të njeriut dhe komunitete

Sektori për të drejta të njeriut dhe komunitete, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivel komunal.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka:

- monitoron përputhshmërinë e respektimit të standardeve për të drejtat e njeriut në

- fushat: mundësi të barabarta, kundër diskriminimit, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, personat me aftësi të kufizuar, të drejtat e komuniteteve, përdorimin e gjuhëve dhe kundër trafikimit me qenie njerëzore;
- këshillon për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës, në përputhje me standardet për të drejtat e njeriut dhe legjislacionit vendor;
 - monitoron aktivitetet e Komunës dhe, në të njëjtën kohë, këshillon Kryetarin e Komunës lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut;
 - harton dhe zhvillon planet e veprimit, identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve dhe planifikon buxhetin për zbatimin e aktiviteteve të NJDNJK-së;
 - raporton në baza mujore, tremujore dhe gjashtëmujore, sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës;
 - zbaton ligjet, planet dhe strategjitë e miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës;
 - bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat e nivelit komunal dhe OJQ – të, në sferën e mbrojtjes dhe promovimin e të drejtave të njeriut;
 - bashkëpunon me institucionet dhe agjencitë qendrore, me qëllim të realizimit të përgjegjësisë, duke përfshirë edhe institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë;
 - merr pjesë në mbledhjet e komitetet ekzistuese (Komiteti për Komunitete, Komiteti për Ndërmjetësim, apo Komiteti për Financa) dhe në forumet tjera, ku çështjet lidhur me të drejta e njeriut dhe komunitetet janë pjesë e rendit të ditës.

Sektori ligjor

Sektori ligjor i Komunës, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë që ka:

- ofron ndihmë juridike, këshillime dhe bën ekspertizë për nevojat e Kabinetit të Kryetarit, drejtorive, sektorëve/njësive dhe të institucioneve të arsimit, të shëndetësisë dhe të ndërmarrjeve komunale;
- shqyrton të gjitha projektregulloret që propozuesit ia dërgojnë për miratim Këshillit të Drejtorëve, komiteteve kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës;
- shqyrton propozimet e vendimeve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit për miratim;
- harton vendime dhe urdhëresa administrative, të kërkuara nga Kryetari i Komunës;
- ruan dokumentacionin e Zyrës ligjore dhe bën shtypjen e të gjitha materialeve dhe akteve të tjera nga përgjegjësia e kësaj zyre;
- bashkëpunon me bashkëpunëtorët profesionalë dhe iu ndihmon atyre në aspektin ligjor në përgatitjen e vendimeve dhe akteve tjera juridike, si dhe të materialeve tjera të ndryshme;
- përfaqëson dhe mbron interesin e Komunës dhe të institucioneve që financohen nga Komuna në procedurat gjyqësore civile, penale, përmbaruese dhe administrative në gjykatat e vendit në të gjitha nivelet;
- ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror dhe juridik të Komunës, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj;

- kryen edhe punë të tjera të parapara me ligj, me Statutin e Komunës së Prishtinës dhe me rregullore të tjera.

Sektori i prokurimit

Sektori i prokurimit, aktivitetin, kompetencat dhe përgjegjësitë i ushtron në kuadër të Ligjit (në fuqi) për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, akteve dhe autorizimeve të autoritetit kontraktues - Kryetarit të Komunës, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi; Sektori i prokurimit dhe zyrtari i prokurimit, në kuadër të obligimeve, autorizimeve dhe përgjegjësiave ligjore dhe duke hyrë në raporte kontraktuale me fondet publike dhe burimet publike, obligohet që ato t'i përdorin në mënyrën më ekonomike, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Sektori i prokurimit, aktivitetin e saj në fushën e prokurimeve e bazon në parimet e ekonomizimit dhe të transparencës, si dhe në atë të barazisë në trajtim të mos diskriminimit dhe efikasitetit të ushtrimit të aktiviteteve të prokurimeve.

Komuna e Prishtinës (si autoritet kontraktues) obligohet, me këtë edhe departamenti/Sektori i prokurimit, që në fushën e menaxhimit, shfrytëzimit, organizimit dhe deponimit në burimet publike dhe fonde publike në fushën kontraktuale të punëve publike në interes për Komunën e Prishtinës, siguron dhe është përgjegjës që:

- të gjithë operatorët ekonomik t'i trajtojë në mënyrë të barabartë dhe pa kurrfarë diskriminimi (si dhe pa kurrfarë favorizimi) dhe të veprojnë me transparencë të plotë, në të gjitha fazat e prokurimit. Në këtë cilësi, zyrtari i prokurimeve obligohet dhe është përgjegjës që të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar në procedurat e tenderimit;
- të bëjë publikimin e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit, në përputhje me ligjin;
- të sigurojë dhe eliminojë çdo tendencë të dhënies së kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë apo favorizojnë një apo më shumë operatorë ekonomikë;
- të sigurojë që të gjitha specifikacionet teknike të precizohen paraprakisht dhe me saktësinë më të madhe të mundshme, duke përfshirë të gjitha kërkesat dhe kriteret, si dhe metodat e përzgjedhjes së dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës;
- konkursit të projektimit në ftesën për tender, ose pjesëmarrje dhe në dosjen e tenderit, dhe që asnjë kërkesë, kriter apo specifikim që nuk është saktësuar, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes dhe të dhënies së kontratës me fondet publike në Komunën e Prishtinës;
- të mbajë evidencën për tërë procesin e prokurimeve, prej fillimit të aktivitetit të prokurimit e deri në dhënien e kontratës;
- në përputhje me ligjet dhe procedurat në fuqi, palës së interesuar (operatorit ekonomik) t'i ofrojë qasje të drejtpërdrejtë në të gjitha të dhënat lidhur me një aktivitet të prokurimit, përveç informacioneve sekrete afariste;
- kontrata publike, t'i jepet operatorit ekonomik që i ka plotësuar të gjitha kriteret më parë të publikuara në njoftimin e kontratës;

- të ruajë deklaratat e nevojave të Kryetarit të Komunës dhe vendosmërisë për disponueshmërinë e fondeve të ZKF-së, Sektori i prokurimit, bën hetimet adekuate të tregut për mallrat, shërbimet ose punët që janë objekt i kontratave (objekt prokurimi);
- të zbatojë rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore, kur rrethanat kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente për Komunën, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi;
- të kujdeset dhe ta njoftojë Kryetarin e Komunës për formimin e komisionit për hapjen publike të tenderëve dhe të komisionit për vlerësimin e tyre;
- të kujdeset dhe të zbatojë ndalesat sipas dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me operatorët ekonomikë, të cilët konkurrojnë për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me Komunën e Prishtinës (duke u kërkuar dëshmi valide);
- të kujdeset që me raportet kontraktuale të Komunës, të shqyrtojnë dhe vlerësojnë besueshmërinë e operatorëve ekonomikë, rreth gjendjes së tyre ekonomike dhe financiare, si dhe aftësive të tyre teknike dhe profesionale;
- t'i propozojë Kryetarit të Komunës (autoritetit kontraktues) themelimin e jurisë vlerësuese dhe kriteret e përgjegjësisë së tyre sipas ligjit në konkurset e projekteve në interes të Komunës;
- është përgjegjës dhe mban të gjitha format e përgjegjësisë ligjore, sipas Kodit penal të Kosovës, dhe i nënshtrohet dispozitave ndëshkuese të këtij kodi, për ndikim të paligjshëm në prokurim dhe mashtrim në prokurim;
- Zyrtari i prokurimit të autoritetit kontraktues, është personi i vetëm i autorizuar për lidhjen dhe nënshkrimin e një kontrate publike në emër të autoritetit kontraktues (Komunës), pas plotësimit të të gjitha kushteve të parapara ligjore;
- Zyrtari i prokurimit është shërbyes civil dhe përgjigjet sipas dispozitave të Ligjit për shërbimin civil të Kosovës dhe largohet sipas procedurave të parapara me këtë ligj.
- Sektori i prokurimit ushtron edhe funksione të tjera administrative në bazë të ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nënligjore, si dhe në bazë të vendimeve apo urdhëresave të Kryetarit të Komunës, të cilit i përgjigjet me raporte periodike 3-mujore dhe vjetore.
- Kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Prishtinës dhe me rregulloret në fuqi.

NR.	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	70,000	70,000	70,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	70,000	70,000	70,000

	Stafi	12	12	12
--	--------------	-----------	-----------	-----------

ZYRA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit:

Deklarata e misionit: Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjet në fuqi, Statutin e Komunës, rregulloret, udhëzimet e Kuvendit të Komunës, Zyra e Kuvendit duhet:

- të ofrojë zbatimin e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase;
- të organizojë punën e Kuvendit të Komunës, duke planifikuar buxhetin kujdeset për menaxhimin optimal të tij;
- kryen punët administrative dhe profesionale, duke përfshirë këtu edhe punët teknike për organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve punuese të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu edhe përpilimin e projekt-akteve që i procedohen për miratim këtyre organeve;
- të kryejë punët të tjera për të gjitha organet e administratës, duke përfshirë këtu pranimin e shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivit dhe ekspeditivit.

Deklarata e vizionit: Duke menaxhuar me buxhetin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, konform vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi, duke përfshirë këtu edhe vendimet e Kuvendit të Komunës, angazhohet që qytetarëve të komunës t'u ofrohen shërbime sa më të mira dhe më të shpejta, konform detyrave dhe përgjegjësisive të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu lëshimin e dëshmimeve për anëtarët e Kuvendit të Komunës, përpilimin e vendimeve të Kuvendit, ekspeditivin e akteve zyrtare e materialeve për nevojat e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, bën përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe lëndëve, arkivimin e lëndëve etj..

Deklarata e qëllimit: Qëllimi i punës së kryesuesit të Kuvendit është që, duke e njohur nevojën për të sjellë vendimmarrjen më afër qytetarëve, të promovojë qeverisje të mirë dhe kushte të jetesës për të gjithë qytetarët e komunës, duke avancuar një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike në Komunën e Prishtinës.

Me një menaxhim sa më të mirë të punës së Kuvendit, të organizojë sa më mirë punën e personelit të shërbimit profesional të Kuvendit, me menaxhim optimal të buxhetit të saj, të krijojë kushte për punë efikase dhe transparente të Kuvendit të Komunës dhe të trupave të tij, në mënyrë që qytetarëve, në bazë të kompetencave tona, t'u ofrohen shërbime në afatet e parapara me ligj, me pretendim që këto afate të jenë sa më të shkurtra.

NR.	Kategoritë ekonomike	2021	2022	2023
1	Paga dhe mëditje	200,000	200,000	200,000
2	Mallra dhe shërbime			

3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	200,000	200,000	200,000

	Stafi	-	-	-
--	-------	---	---	---

DREJTORITË E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Drejtoria e Administratës

Deklarata e misionit:

Zbatimi i dispozitave ligjore, rregulloreve në organet e administratës komunale. Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka kjo drejtori:

- organizon metodën e punës në organet komunale të administratës;
- lëshon certifikata dhe akte të tjera nga evidenca zyrtare që mban;
- planifikon buxhetin e Drejtorisë dhe kujdeset për menaxhimin optimal të tij;
- kryen punët administrative për nevojat e këtyre organeve, që kanë të bëjnë me: përgatitjen profesionale, teknike dhe organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Bordit të Drejtorëve dhe trupave punues të emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe Bordi i Drejtorëve, si dhe përpunimin profesional të akteve të miratuara nga këto mbledhje.

Punët e përbashkëta për të gjitha organet e administratës: Punët e pranimit të shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin e tyre, punët e arkivit dhe ekspeditimit, zbatimin e procedurave ligjore nga lëmi i marrëdhënies së punës, mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve, prokurimin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, nxehjen qendrore, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e automjeteve të Komunës dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kompjuterëve.

Deklarata e vizionit:

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka:

- lëshon deklaratat për gjendjet e përbashkëta familjare;
- përgatit vërtetimin e nënshkrimeve personale;
- lëshon vërtetime për varshmërinë materiale në diasporë etj.;
- lëshon certifikata në bazë të dy dëshmitarëve dhe provave tjera;
- protokollon, pranon shkresat nga palët, sistemon, evidenton dhe dërgon aktet në përpunim të mëtejshëm sipas drejtorive dhe sektorëve të veçantë, dhe bën ekspeditivin e akteve zyrtare e materiale për nevojat e Kuvendit të Komunës;
- bën përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe i lëndëve, pranimin, hapjen, klasifikimin e postës, dërgimin e postës, arkivimin e lëndëve, ruajtjen e lëndëve arkivore të përfunduara;

- ndarjen e materialit të pavlefshëm të regjistraturës dhe dorëzimin e lëndës arkivore, arkivit kompetent, shpërndarjen e thirrjeve përmes centralit telefonik etj..

Deklarata e qëllimit:

Drejtorja e Administratës dhe Personelit:

- bën regjistrimin e të porsalindurve në LAL;
- bën regjistrimin e të vdekurve në LAV;
- bën celebrimin e martesave dhe regjistrimin në LAM;
- mban librat amzë të të lindurve;
- mban librat amzë të të martuarve;
- mban librat amzë të të vdekurve;
- bënë ndryshime dhe përmirësime të emrave personale, sipas kërkesës së palës;
- lëshon certifikata për faktet që mbajnë evidencë sipas detyrës zyrtare;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore;
- bënë përgatitjen dhe organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe përpunimin profesional të akteve të miratuara në seanca;
- ruan dokumentacionin dhe burimet e dokumenteve,
- mban evidencën e mbledhjeve të mbajtura të Kuvendit dhe komiteteve, procesverbaleve dhe stenogramet nga seancat e Kuvendit;
- bën publikimin e vendimeve dhe akteve të tjera të miratuara nga këto organe në Gazetën zyrtare dhe mjetet tjera të informimit;
- kryen punë profesionale për anëtarët e Kuvendit, organet e tij, lidhur me mirëvajtjen e punës, sidomos rreth peticioneve, ankesave, parashtrësive, të cilat në forma të ndryshme i drejtohen këtyre organeve dhe komiteteve të zgjedhura nga Kuvendi i Komunës;
- përgatit procedurat e nevojshme lidhur me tubimet publike të Kuvendit të Komunës me qytetarë, bashkësitë lokale dhe organizmat tjerë relevantë;
- jep instruksione profesionale lidhur me materialet që i shqyrton Kuvendi, Bordi i Drejtorëve dhe Komitetet e Kuvendit;
- kryen detyra tjera sipas udhëzimeve dhe urdhëresave të Kryetarit të Komunës;
- zbaton Ligjin mbi shërbimin civil dhe zbaton urdhëresat administrative lidhur me zbatimin e procedurave të shpalljes së konkurseve, rekrutimit, selektimit, mirëmbajtjes së dosjeve të punëtorëve të shërbimit civil dhe të procedurave tjera që dalin nga ligji dhe udhëzimet administrative që rregullojnë këtë fushë;
- është përgjegjëse për zbatimin e procedurës së tenderimit, në bazë të rregullativës ligjore në fuqi;
- merret me administrimin e rrjetit të kompjuterëve, përpunimin e ueb-faqes së Komunës dhe përcjelljen e trendëve bashkëkohorë nga fusha e teknologjisë informative.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	760,000	776,500	783,783
2	Mallra dhe shërbime	13,501,630	14,205,997	14,471,054
3	Shpenzime komunale	1,034,583	1,091,390	1,181,663
4	Subvencione	1,036,215	1,436,829	1,798,701
5	Investime kapitale	575,000	575,000	575,000
	GJITHSEJ:	16,907,428	18,085,716	18,810,201
	Stafi	140	140	140
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Furnizimi me pajisje të TI-së për nevojat e Komunës së Prishtinës	50,000	50,000	50,000
2	Mirëmbajtja e objektit të vjetër të Komunës, BL-ve dhe objekteve tjera komunale	80,000	80,000	80,000
3	Renovimi i godinës së zjarfikësve te kodra e trimave	45,000	45,000	45,000
4	Dixhitalizimi i shërbimeve në sportele	50,000	50,000	50,000
5	Renovimi i përgjithshëm i DIKMK-së, obj. i vjetër i Komunës, kati 4	70,000	70,000	70,000
6	Ndërrimi i tubacionit, enës ekspanduese, valvulave dhe radiatorëve të ngrohjes	280,000	280,000	280,000
	Totali	575,000	575,000	575,000

Drejtoria e Financave

Deklarata e misionit: Misioni i kësaj drejtorie është menaxhimi i buxhetit dhe financave të Komunës, që d.m.th.:

- siguron drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe zhvillimin ekonomik;
- informon liderët komunalë me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e Komunës;
- përgatit rregulloret për KPF;
- bën menaxhimin e financave komunale;
- bën përgatitjen e prezantimit të buxhetit;
- koordinon punët dhe aktivitetet e drejtorisë;
- këshillon zyrtarët komunalë për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat.

Deklarata e vizionit: Në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive që ka kjo drejtori:

- menaxhon me buxhetin komunal;

- përgatit buxhetin komunal për të gjitha programet buxhetore brenda afateve kohore të përcaktuara nga MEF-i, duke u bazuar në qarkoret buxhetore dhe dokumentacionin plotësues;
- bën rishikimin buxhetor, analizat, raportet periodike financiare etj.;
- perfeksionimi i mbajtjes së evidencës së kontabilitetit dhe mundësia për ngritjen në nivel më të lartë.

Spektori i tatimit në pronë, menaxhon ekskluzivisht vetëm tatimin në pronë:

- përgatitjen e faturave;
- shpërndarjen e faturave tatimore;
- planifikimin e arkëtimit të tatimit në pronë dhe raportimin e rregullt pranë MFE-së, Zyrës regjionale dhe Drejtorisë për realizimin e të hyrave nga tatimi në pronë, në baza mujore, si dhe përmbushja e planit vjetor;
- pasurimin dhe inkorporimin e elementeve shtesë për skemën e tatimit dhe freskimin vjetor të të dhënave me gjendjen në terren dhe aprovimin e ndryshimeve – plotësimeve të rregulloreve komunale të tatimit në pronë dhe tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale për këtë kategori të të hyrave.

Deklarata e qëllimit: Synimi i kësaj drejtorie është që:

- të ngrihet niveli i menaxhimit të financave komunale për të gjithë administratën lokale;
- të mbajë kontabilitetin dhe financat;
- të përpilojë raportet mujore dhe vjetore mbi financat komunale;
- të mbajë evidencën e kontabilitetit për të hyrat vetanake komunale për çdo program buxhetor, si dhe barazimet periodike (mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore me MF-në, Departamentin e Thesarit). Zyra menaxhon të gjitha shpenzimet e Komunës, sipas udhëzimeve nga MF-ja. Për secilën program buxhetor, përmes sistemit të kontabilitetit të Free-Balancee, përmes të cilit bëhet realizimi i shpenzimeve buxhetore (alokimi, zotimi dhe realizimi i pagesave), duke u bazuar në rrjedhjen e parasë së gatshme Cash– planit.

Spektorit i tatimit në pronë

Deklarata e misionit: Tatimi në pronë është tatim vjetorë i Komunës. Të hyrat nga tatimi në pronë përdoren për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunën tuaj. Duke paguar tatimin në pronë, ju jeni duke u bërë pjesë e përpjekjeve për të zhvilluar komunën tuaj.

Tatimi në Pronë është tatim vjetor të cilin e vendos Komuna. Tatimi caktohet për të gjitha pronat e paluajtshme që janë nën apo mbi nivelin e tokës. Kjo përfshin njësitë brenda ndërtesave, si apartamente dhe hapësira për përdorim komercial. Disa institute dhe organizata përjashtohen nga ngarkesa me tatim në pronë. Të hyrat e grumbulluara nga tatimi në pronë, së bashku me të hyrat tjera, përdoren për zhvillimin e infrastrukturës në komunën tuaj, si: rrugë, shkolla, ambulanca dhe investime të ngjashme, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës në komunën tuaj. Pritet që nga viti 2020, komunat të fillojnë arkëtimit të tatimit në tokë. Kjo është potencuar edhe me Qarkoren buxhetore 2020/01 dhe 2020/02, ku si plan i të hyrave është inkorporuar edhe tatimi në tokë.

NR.	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	350,000	350,000	350,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	350,000	350,000	350,000

	Stafi	71	71	71
--	--------------	-----------	-----------	-----------

Drejtoria e Inspeksionit

Deklarata e misionit: Që të zhvillojë dhe të sigurojë me efektivitet dhe efikasitet:

- kushtet higjiene-sanitare dhe teknike në ambientet ku jetojnë qytetarët e Prishtinës, ku punojnë, edukohen, shërohen, argëtohen etj.;
- normat dhe standardet e operatorëve që kryejnë veprimtari ligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie;
- implementimin e masave dhe programeve preventive, përmes zhvillimit dhe forcimit të inspektimeve kompetente ligjore.

Deklarata e vizionit: Vizioni i DI-së është mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit publik, mbikëqyrja dhe aplikimi i ligjeve për planin zhvillimor, rregullues dhe urbanistik, përmes inspektimeve, vendimeve, pëlqimeve, evidentimeve dhe ndërmarrjes së masave ligjore ndaj subjekteve – operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie, duke siguruar kushte dhe ambient të shëndoshë për qytetarët e Prishtinës.

Deklarata e qëllimit: Mbikëqyrja dhe aplikimi i ligjeve dhe akteve të tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut sanitar, veterinarisë, bujqësisë, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban - komunikacionit, hidroekonomisë, rrugëve etj. Promovimi i kushteve higjiene - sanitare dhe teknike në institucionet publike dhe private. Zhvillimi i resurseve humane dhe forcimi i llogaridhënies.

NR.	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	400,000	400,000	400,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	400,000	400,000	400,000

	Stafi	68	68	68
--	--------------	-----------	-----------	-----------

Drejtoria e Urbanizmit

Deklarata e misionit: Misioni parësor i Drejtorisë së Urbanizmit është krijimi i një ambienti të shëndoshë për banim, punë, rekreacion, duke respektuar rregullativën ekzistuese ligjore. Drejtoria është bartëse kryesore e hartimit të detyrave projektuese për planet zhvillimore komunale –urbane dhe planeve rregulluese urbane, njëherësh bën implementimin e tyre, lëshon lejet e ndërtimit, kujdeset për dokumentacionin investivo – teknik dhe përputhshmërinë e tij me kushtet e dhëna urbano - teknike. Lejon shfrytëzimin e hapësirave publike, mbulon sferën e banimit, zbaton vendimet e gjykatës për ndarje, bartje të pronësisë dhe bashkëpunon ngushtë me nivelin qendror – Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencinë Kadastral të Kosovës.

Deklarata e vizionit: Kujdeset për zbatimin e planeve zhvillimore dhe planeve rregulluese urbane, dhënien e lejeve të ndërtimit konform rregullativave ekzistuese, kontrollimin e dokumentacioneve investivo - teknike, shfrytëzimin e sipërfaqeve publike në përputhje me rregulloret dhe realizimin e mjeteve financiare, duke paraqitur shtyllën kryesore të të hyrave vetanake në buxhetin komunal.

NR.	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	170,000	170,000	170,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale	-	-	-
	Gjithsej:	170,000	170,000	170,000

	Stafi	33	33	33
--	--------------	-----------	-----------	-----------

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

Deklarata e misionit: Në bazë të përgjegjësive dhe kompetencave që ka, kjo drejtori:

- është bartëse e procedurave të hartimit të Planit zhvillimor komunal – urban, Hartës zonale dhe planeve rregulluese urbane;
- merret me monitorimin dhe evoluimin e këtyre planeve;
- harton propozimet dhe kushtet e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim me interes të përgjithshëm shoqëror;
- jep hapësirat publike në shfrytëzim të përkohshëm;
- kujdeset për zbatimin e ligjeve të fushës së planifikimit hapësinor, si Ligjit për planifikim hapësinor të Kosovës (LPH), respektimit të rregullativës ekzistuese ligjore.

Deklarata e vizionit: Drejtorja siguron drejtime dhe koordinon me zyrat tjera komunale dhe me bizneset private. Administrata bënë planifikimin dhe mbikëqyr punën e bërë në bazë të Planit të zhvillimit ekonomik lokal. Administrata jep këshillime për komunitetin e biznesit dhe kryen shërbime të tjera.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	100,000	100,000	100,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale	100,000	100,000	100,000
	GJITHSEJ:	200,000	200,000	200,000
	Stafi	17	17	17
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Masat e EE-Efiqencës dhe energjisë për ndërtesë të banimit në bashkëpronësi.	100,000	100,000	100,000
	Totali	100,000	100,000	100,000

Drejtoria e Kadastrit:

Deklarata e vizionit: Drejtoria është përgjegjëse për:

- zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale;
- rrjetin referues homogjen;
- rikonstruktimin e informatave kadastrale në formë digjitale;
- modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën;
- ofrimin e shërbimeve profesionale dhe shërbimeve të tjera për subjekte të interesuara, përmirëson transferimin e tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në tatimin e tokave;
- planifikon rrjetin me pika të reja kontrolluese dhe themelon pika të reja kontrolluese; digjitalizon pikat poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale);
- azhurnon pjesën grafike, në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe i transformon me parametrat e dhëna për transformim;
- ofrimin e shërbimeve rreth mirëmbajtjes dhe klasifikimit të kulturave të tokës..

NR.	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	140,000	140,000	140,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	Gjithsej:	140,000	140,000	140,000
	Stafi	30	30	30

Drejtoria e Shëndetësisë

Drejtoria e Shëndetësisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe mbështetur në udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, në kuadër të fushë-veprimtarisë së saj:

- ushtron dhe është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve specifike, për të arritur objektivat e shërbimit të shëndetësisë parësore në komunën së Prishtinës; vlerëson nevojat lokale shëndetësore, harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- zbaton kujdesin parësor shëndetësor, duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare;
- zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore, sipas akteve ligjore të miratuara nga MSH-ja;
- vendos dhe mbledh bashkëpagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;
- përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel të komunës;
- mbledh dhe analizon informatat në fushën shëndetësore në nivel lokal;
- koordinon dhe mbikëqyr punën e QKMF-së, QMF-së dhe ambulancave shëndetësore;
- organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën shëndetësore;
- raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- harton propozimet për lirimet nga shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;
- ndërmerr veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve shëndetësorë nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi;
- zbaton kujdesin parësor shëndetësor në sektorin publik, nëpërmjet shërbimeve të Mjekësisë Familjare, dhe përcjelljen e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e komunës;
- harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuar në nivel lokal, duke u dhënë prioritet masave parandaluese, dhe në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë dhe pozitës ekonomiko - sociale të qytetarëve dhe kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor, kushteve teknologjike - mjekësore, distancës dhe konfiguracionit gjeografik, si dhe strukturës dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	7,650,000	7,650,000	7,650,000
2	Mallra dhe shërbime	1,694,300	1,694,300	1,694,300
3	Shpenzime komunale	300,000	300,000	300,000
4	Subvencione	250,000	250,000	250,000
5	Investime kapitale	1,100,000	1,100,000	1,100,000
	GJITHSEJ:	10,994,300	10,994,300	10,994,300
	Stafi	871	871	871
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Ndërtimi i QMF Veternik	250,000	250,000	250,000
2	Furnizim me pajisje mjekësore	100,000	100,000	100,000
3	Furnizimi me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore	100,000	100,000	100,000
4	Renovime dhe rindërtime të objekteve shëndetësore	150,000	150,000	150,000
5	Furnizim me autovetura për shërbime shëndetësore	200,000	200,000	200,000
6	Zgjerimi i garazheve të QMU-së, krijimi i ambientit të mbyllur për autoambulancë	150,000	150,000	150,000
7	Digjitalizimi i laboratoreve shëndetësorë	150,000	150,000	150,000
	Totali	1,100,000	1,100,000	1,100,000

Drejtoria e Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Mirëqenies Sociale, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe mbështetur në udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, në kuadër të fushë-veprimtarisë së saj:

- ushtron dhe është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve specifike për të arritur objektivat e shërbimeve sociale të komunës së Prishtinës;
- vlerëson nevojat lokale për shërbime sociale;
- harton buxhetin në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore, sipas akteve ligjore të miratuara nga niveli qendror;
- vendos dhe mbledh bashkëpagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;
- përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e shërbimeve sociale;
- ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës brenda territorit të komunës;

- kujdeset për të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda territorit të komunës;
- bashkëpunon me ministritë e linjës përkatëse për vendosjen dhe zbatimin e politikave sociale, për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha grupet tjera vulnerabile në nivelin lokal;
- përmes QPS-së, mbledh dhe analizon informatat në fushën sociale në nivel lokal;
- organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën sociale;
- koordinon dhe mbikëqyrë punën e Qendrës për Punë Sociale;
- raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- propozon nivelin e qirasë dhe vendosjes së nivelit të lirit nga pagesa e qirasë për objektet në pronësi;
- harton propozimet për lirimet nga shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;
- përgatit planet vjetore për zhvillimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajtjen e shënimeve statistikore;
- përkujdesjet për sigurimin e strehimit për të pastrehët;
- ndërmerr veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve socialë;
- nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi, bashkëpunon me ministritë e linjës në sigurimin, distribuimin dhe ruajtjen e statistikave, informatave dhe konfidencialitetit të familjeve që marrin shërbime socio – familjare;
- sipas legjislacionit në fuqi, siguron fonde optimale për trajnimin e vazhdueshëm të profesionistëve socialë, me qëllim të ngritjes së shërbimeve socio – familjare;
- kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	265,000	265,000	265,000
2	Mallra dhe shërbime	1,105,000	1,105,000	1,105,000
3	Shpenzime komunale	28,000	28,000	28,000
4	Subvencione	800,000	800,000	800,000
5	Investime kapitale	1,150,000	1,150,000	1,150,000
	GJITHSEJ:	3,348,000	3,348,000	3,348,000
	Stafi	49	49	49
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Ndërtimi i Qendrës Multifunkionale për Punë Sociale	500,000	500,000	500,000
2	Ndërtimi i dhe Inventarizimi Strehimores për Personat e Komuniteti LGBTI	300,000	300,000	300,000
3	Furnizim me Inventar dhe Pajisje Ndihmëse për Shërbime Direkte Sociale	175,000	175,000	175,000
4	Inventarizimi Pushimores për të Moshuar në Istog	70,000	70,000	70,000
5	Renovimi dhe Inventarizimi i Shoqatës Qëndrore të Personave të Shurdhër	80,000	80,000	80,000
6	Ndërtimi dhe Inventarizimi i Qendres për Qëndrim Ditor për të Moshuar	25,000	25,000	25,000
	Totali	1,150,000	1,150,000	1,150,000

Drejtoria e Arsimit

Deklaratë e misionit: Edukimi dhe arsimimi i gjeneratave të reja, që nga niveli parashkollor deri tek shkollimi i mesëm i lartë, duke përfshirë të gjithë, pa dallim etnie, race dhe përkatësie fetare. Zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve administrative të MASHT-së dhe i ligjeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me arsimin, siç janë:

- respektimi dhe zbatimi i vendimeve që dalin nga Bordi ekzekutiv dhe Kuvendi i Komunës;
 - zbatimi dhe qasja e drejtë e reformave shkollore, me qëllim të arritshmërisë në shkallën më të lartë, bazuar në standardet evropiane dhe botërore;
 - zbatimi dhe qasja e drejtë në vlerësimin e njohurive të nxënësve;
 - nxitja e bashkëpunimit me të gjitha shoqatat dhe organizatat që kanë të bëjnë me lëmin e arsimit dhe edukimit;
 - bashkëpunimi me DKA-të në nivel vendi;
 - bashkëpunimi dhe përvetësimi i përvojave në fushën e arsimit, jo vetëm në nivel vendi, por edhe më gjerë, veçmas me Republikën e Shqipërisë;
 - nxitja e bashkëpunimit ndërmjet arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve, bashkëpunimi me Zyrën e inspeksionit në nivel rajonal;
 - aftësimi profesional i personelit arsimor;
 - krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e mësimin;
 - krijimi i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, që kanë të bëjnë me formimin e personalitetit të të gjithë nxënësve;
 - përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës shkollore;
 - përgatitja e objekteve shkollor për fillimin me kohë të vitit shkollor, kalendarit të punës, planprogrameve mësimore dhe dokumentacionit pedagogjik;
 - mbikëqyrja e përgjithshme e punës edukativo-arsimore;
- Në kuadër të kësaj, DKA në Prishtinë ka në menaxhimin e saj: çerdhe fëmijësh, shkollë artistike, shkolla fillore dhe shkolla të mesme të larta.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	18,980,000	19,120,000	19,270,000
2	Mallra dhe shërbime	4,268,000	4,268,000	4,268,000
3	Shpenzime komunale	760,000	760,000	760,000
4	Subvencione	300,000	300,000	300,000
5	Investime kapitale	4,480,000	4,480,000	4,480,000
	GJITHSEJ:	28,788,000	28,928,000	29,078,000
	Stafi	3095	3095	3095
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Furnizimi i bibliotekave shkollore	50,000	50,000	50,000
2	Vendosja e kamerave të sigurisë	100,000	100,000	100,000
3	Pajisja e disa shkollave me rekuizita sportive	150,000	150,000	150,000
4	Rregullimi i oborreve dhe rrethojave të terreneve sportive	250,000	250,000	250,000
5	Rikonstruktimi dhe gëlqerosja e shkollave	1,000,000	1,000,000	1,000,000
6	Furnizimi me inventar	200,000	200,000	200,000
7	Pajisja me kabinete	200,000	200,000	200,000
8	Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës	100,000	100,000	100,000
9	Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në shkolla	250,000	250,000	250,000
10	Furnizim me pajisje teknologjike për nevoja të arsimit	125,000	125,000	125,000
11	Ndërtimi i pishinës për nxënës të Prishtinës të shkolla "Dardania"	755,000	755,000	755,000
12	Ndërtimi i aneksit të shkollës " Pavaresia"	250,000	250,000	250,000
13	Ndërtimi i sallave të edukatës fizike të SHF Gjergj Fishta dhe shkolles ekonomike	650,000	650,000	650,000
14	Ndërtimi i çerdhes Xixillonja në Prishtinë	400,000	400,000	400,000
	Totali	4,480,000	4,480,000	4,480,000

Drejtoria e Kulturës

Deklarata e misionit: Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të Drejtorisë janë:

- avancimi i përgjithshëm i vlerave kulturore kombëtare dhe sportive;
- shënimi i përvjetorëve të personaliteteve të kulturës dhe historisë kombëtare, të të gjitha kohërave;
- formimi i shoqërive kulturo-artistike, grupeve dhe ekipeve sportive;
- përkrahja e talenteve të reja, në veçanti krijimi i kushteve për zhvillimin e veprimtarive kulturo-artistike dhe sportive;
- prezantimi i denjë i Komunës në nivel vendi dhe më gjerë;
- kujdesi dhe mirëmbajtja e institucioneve të kulturës, rinisë dhe sportit dhe ndërtimi i objekteve të reja;
- nxitja e bashkëpunimit me shoqëritë kulturo-artistike, me grupet rinore dhe ekipet sportive në nivel vendi dhe më gjerë;
- ngjitja e vetëdijes njerëzore në aspektin e dashurisë dhe humanizmit;
- nxitja dhe përkrahja e krijuesve të fjalës artistike;
- botimi i veprave me vlera kulturore e historike kombëtare;
- shtrirja e aktivitetit të sektorit të sportit edhe në shkollat e komunës, me qëllim të zbulimit e të ndihmës së talenteve të reja në fushën e kulturës e të sportit, organizimi i garave në nivel komune, rajoni, vendi e më gjerë.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	405,000	405,000	405,000
2	Mallra dhe shërbime	450,000	450,000	450,000
3	Shpenzime komunale	30,000	30,000	30,000
4	Subvencione	800,000	800,000	800,000
5	Investime kapitale	2,020,000	2,020,000	2,020,000
	GJITHSEJ:	3,705,000	3,705,000	3,705,000
	Stafi	82	82	82
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Furnizim me libra.	70,000	70,000	70,000
2	Salla Koncertale	900,000	100,000	100,000
3	Ndërtimi dhe renovimi i Muzeumeve, Qendrave Socio-Kulturore dhe Teatrove të qytetit të Prishtinës	400,000	900,000	900,000
4	Rigjenerimi i rrugëve në zonën historike të qytetit të Prishtinës dhe Renovim, Restaurim dhe Rekonstruim i Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore	200,000	300,000	300,000
5	Institucionet Vartëse Kulturore (Furnizim me Libra, Pajisje, Renovim, Program, Trajnime, Festivale etj.)	200,000	300,000	300,000
6	Renovimi artistik i Tunelit të Kurrizit (FAZA 2)	100,000	100,000	100,000
7	Renovimi i Amfiteatrit të Qytetit	80,000	150,000	150,000
8	Figurat socio-kulturore të qytetit të Prishtinës	70,000	100,000	100,000
	Totali	2,020,000	2,020,000	2,020,000

Drejtoria e Bujqësisë

Deklarata e misionit: Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka kjo drejtori, janë:

- hartimi i politikave për zhvillimin e bujqësisë;
- bashkëpunimi me MBPZHR-në;
- koordinimi i punëve me OQ dhe OJQ, vendore dhe ndërkombëtare;
- grumbullimi i shënimeve të sakta dhe me kohë për të gjitha fushat e bujqësisë, përgatit planet për mbjelljet vjetore dhe siguron që këto plane të implementohen;
- zhvillimi i ekonomik, i harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave të BE-së, duke respektuar politikat e zhvillimit rural (PZHR) të BE-së, normat ekologjike dhe konkurruese me vendet e rajonit dhe i mbështetur nga fondet zhvillimore qeveritare, lokale dhe ndërkombëtare;
- subvencionimi në forma të ndryshme të qytetarëve, të cilën i përkasin fushave të ndryshme të bujqësisë.

Deklarata e qëllimit: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, në Planin e punës, në kërkesat e qytetarëve, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat përkatëse vendore dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me MBPZHR, realizon aktivitete dhe projekte, ku nëpërmjet subvencioneve, granteve të ndryshme dhe këshillave ndihmon fermerët dhe ekonomitë bujqësore në rritjen e produktivitetit për sektorët parësor të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	65,000	65,000	65,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione	800,000	800,000	800,000
5	Investime kapitale	500,000	500,000	500,000
	GJITHSEJ:	1,365,000	1,365,000	1,365,000
	Stafi	10	10	10
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Mekanizim bujqësor.	100,000	100,000	100,000
2	Thertorja per kafshe ne komunen e Prishtines	400,000	400,000	400,000
	Totali	500,000	500,000	500,000

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Deklarata e misionit: Mbrojtja dhe Shpëtimi i njerëzve, kafshëve, pasurisë, trashëgimisë së kulturës dhe ambientit ku jetojmë dhe veprojmë, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Deklarata e vizionit: Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit përmban programimin, planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin, mbikëqyrjen dhe financimin e masave, si dhe të aktiviteteve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Deklarata e qëllimit: Detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë:

- zbulimi, përcjellja dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- vështrimi, lajmërimi, alarmimi dhe informimi i publikut për rreziqet e mundshme dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- arsimimi dhe aftësimi për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- organizimi i mbrojtjes dhe gatishmërisë emergjente, si dhe mënyrat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- vetëmbrojtja, ndihma, ndihma reciproke;
- aktivizimi i forcave për mbrojtje dhe shpëtim dhe i mjeteve për realizimin e masave mbrojtëse;
- evitimi i pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë;
- mbikëqyrja e përhershme rreth realizimit të rregullave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera;
- vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin e rreziqeve të shkaktuara nga zjarret dhe fatkeqësitë tjera;
- projektet për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera (rrëshqitja e dheut, vërshimet, ortekët e dëborës, fatkeqësitë teknologjike etj.);
- pajisjet e nevojshme të ekipeve për mbrojtje dhe shpëtim pranë Kuvendit të Komunës;
- trajnimi i stafit të drejtorisë, si dhe ekipeve për mbrojtje dhe shpëtim pranë Kuvendit.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	180,000	180,000	180,000
2	Mallra dhe shërbime	60,000	60,000	60,000
3	Shpenzime komunale	30,000	30,000	30,000
4	Subvencione			
5	Investime kapitale	4,490,000	4,490,000	4,490,000
	GJITHSEJ:	4,760,000	4,760,000	4,760,000
	Stafi	32	32	32
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal.	500,000	500,000	500,000
2	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik .	600,000	600,000	600,000
3	Ndërtimi i semaforëve dhe modernizimi.	150,000	150,000	150,000
4	Rregullimi i vendeve të kontejnerëve dhe furnizimi.	200,000	200,000	200,000
5	Pastrimi i lumenjve dhe kanalizimi atmosferik.	120,000	120,000	120,000
6	Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve.	200,000	200,000	200,000
7	Rregullimi i varrezave në komunën e Prishtinës.	250,000	250,000	250,000
8	Trajtimi i mbeturinave ndërtimore.	100,000	100,000	100,000
9	Shtyllat antiparking dhe pistonet lëvizëse.	100,000	100,000	100,000
10	Projekti i kogjenerimit NQ "Termokos".	1,000,000	1,000,000	1,000,000
11	Marrëveshja me MCM për matësa për ngrohje.	1,000,000	1,000,000	1,000,000
12	Rregullimi i pompave për furnizim me ujë për ndërtesat kolektive dhe mirëmbajtja.	70,000	70,000	70,000
13	Mobileria urbane.	200,000	200,000	200,000
	Totali	4,490,000	4,490,000	4,490,000

Drejtoria e Pronës

Deklarata e misionit: Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi qe ka:

- menaxhon me pronën në pronësi komunale;
- mban shënime për tokën dhe objektet në pronësi të Komunës;
- zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për ngastrat e planifikuara për interes publik sipas planeve urbanistike të Komunës;
- përgatit vendimet e shpronësimit për personat fizikë dhe juridikë;
- arrin marrëveshje dhe nënshkruan kontrata, me anë të së cilave siguron tokën e nevojshme për realizimin e interesit publik;
- nxjerr vendime për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në emër të Komunës, në paluajtshmëritë e mbetura pa pronar;
- trajton dhe zhvillon procedurën administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës;
- nxjerr vendimet për lirim të pronës komunale të uzurpuar arbitrarisht;
- shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative, për rregullimin e marrëdhënieve pronësore – juridikë lidhur me pronën komunale;

- zhvillon procedurat administrative, sipas detyrës zyrtare, për ruajtjen e pronës komunale dhe interesit tjetër komunal;
- bën identifikimin dhe matjet gjeodezike në bazë të kërkesës së drejtorive për realizimin e projekteve komunale;
- përpunon konkluzionet pas plotfuqishmërisë së vendimit në procedurë administrative dhe pronësore – juridike;
- përgatit iniciimin e procedurës për kallëzim penal, së bashku me përfaqësuesin juridik të Komunës, lidhur me uzurpimet arbitrare të pronës komunale;
- përcjell vendimet që kanë të bëjnë me shpronësimet për publikim në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	95,000	95,000	95,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale			
	GJITHSEJ:	95,000	95,000	95,000
	Stafi	15	15	15

Drejtoria e Investimeve dhe Menaxhimit të Kontratave

Deklarata e misionit: Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka:

- harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të infrastrukturës në nivel të komunës, në përputhje dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe në harmoni me zhvillimin urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale;
- përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore;
- përgatit detyrat projektuese dhe bën kategorizimin e objekteve të infrastrukturës lokale dhe rurale.

Deklarata e qëllimit:

- Harton projektet e vogla të infrastrukturës, sipas kërkesave të bashkësive lokale;
- lëshon leje për ndërtim (të infrastrukturës rrugore) dhe leje për gropim dhe hapje të kanaleve, të cilat i bëjnë ndërmarrjet publike, si dhe leje për kyçje individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës;
- është përgjegjëse për menaxhimin (mbikëqyrjen) e ndërtimit, rindërtimit dhe sanimit të infrastrukturës rrugore (kanalizimet fekale, atmosferike, kabllore, ujësjellësin, asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal) në qytet dhe vise rurale;

- kontrollon dhe mbikëqyrë cilësinë dhe ngjeshmërinë e materialit ndërtimor, nëpërmjet laboratorit të licencuar për përputhshmërinë me norma teknike të pranuar në nivel ndërkombëtar dhe të BE;
- bashkëpunon me organin e prokurimit, me qëllim të jetësimit të kontratave të nënshkruara për kryerjen e punimeve të infrastrukturës lokale;
- kryen punë nga lëmi i gjeodezisë për nevoja të Drejtorisë;
- ruan dokumentacionin e eksproprijimit të pronave gjatë viteve të mëhershme që janë në interes të Komunës;
- arkivon dokumentacionin teknik të infrastrukturës lokale.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	265,000	265,000	265,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale	11,739,188	12,629,817	14,432,643
	GJITHSEJ:	12,004,188	12,894,817	14,697,643
	Stafi	42	42	42
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Rrethrotullimi "Lakërishtë" - rrethrotullimi "Arbëri".	400,000	600,000	600,000
2	Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore.	500,000	500,000	500,000
3	Tregu i ri qytetit (Çarshia e Vjetër, vazhdimi i projektit, vazhdimi i projektit të tenderuar në vitin 2021).	1,500,000	1,500,000	500,000
4	Tuneli "Agim Ramadani" (vazhdimi i projektit të tenderuar në vitin 2021).	300,000	300,000	300,000
5	Implementimi i Planit të mobilitetit, pjesa urbane.	1,000,000	1,500,000	1,832,643
6	Ndërtimi i rrugës "B", faza III.	500,000	500,000	500,000
7	Rruga "A" - kolektori dhe rruga.	1,000,000	1,300,000	1,300,000
8	Tregu i Ulpianes.	200,000	290,629	1,500,000
9	Rregullimi i varrezave të dëshmorëve në Viti të Marecit.	350,000	350,000	350,000
10	Ndërtimi i urava (Zgjerimi i urave ne fshatin Barileve)	239,188	739,188	2,000,000
11	Rikonstruktimi i rrugës "Nekibe Kelmendi".	500,000	500,000	500,000
12	Rruga "Hajdaraj" në Koliq dhe një krah i rrugës .	250,000	150,000	150,000
13	Projekte për zyrën për komunitete dhe kthim.	200,000	200,000	200,000
14	Ndërtimi i rrugës Rimanisht - Siqevë.	250,000	150,000	150,000
15	Ndërtimi i rrugëve në Shkabaj.	300,000	300,000	300,000
16	Ndërtimi i rrugës në Radashec.	300,000	200,000	200,000
17	Ndërtimi i rrugës "Gonxhe Bojaxhiu".	200,000	100,000	100,000
18	Ndërtimi i rrugës "Skënderbeu".	100,000	100,000	100,000
19	Kanalizimet ne fshatrat Mramor, Bardhosh gjere ne Prugovc	200,000	100,000	100,000
20	Ndërtimi i kolektorit në Hajvali.	350,000	250,000	250,000
21	Ndërtimi i rrugës "Brigada e Lirise", faza e dytë.	150,000	150,000	150,000
22	Ndërtimi i rrugicave: "Shemsi Kraja", "Avni Gashi", "Fehmi Pacolli", "Rifat Gashi"	200,000	200,000	200,000
23	Ndërtimi i rruges "Flamuri i Arbërit"+C178.	150,000	150,000	150,000
24	Ndërtimi i rrugës Zllash-Prapashticë, faza e dytë.	300,000	200,000	200,000
25	Ndërtimi i rrugës "Shaban Sjarina".	150,000	150,000	150,000
26	Ndërtimi i rrugës "Mihal Ciko".	200,000	200,000	200,000
27	Ndërtimi i rrugës "Suka"-Keqekolle	150,000	150,000	150,000
28	Ndërtimi i rrugës Zllashi i Vogël - Borocët.	150,000	150,000	150,000
29	Ndërtimi i rrugës në Grashticë .	200,000	200,000	200,000
30	Ndërtimi i rrugës "Brahim Beku" .	200,000	200,000	200,000
31	Ndërtimi i rrugës "Kaçakët" në lagjen "Govorët".	150,000	150,000	150,000
32	Ndërtimi i rrugës "Svirca" -fshati Nishevc	150,000	150,000	150,000
33	Ndërtimi i rrugëve "Rahim dhe Shabi Gerbeshi".	150,000	150,000	150,000
34	Ndërtimi i rrugës "Zekë Pacolli" - Marec	100,000	100,000	100,000
35	Zgjerimi i rjetit te ujsjellsit (Grashtice, Mramor, Busi, Slivov, Siqeve, Barilev lag)	300,000	300,000	300,000
36	Ndërtimi i rruges ne Prapashtice(Nga lagja Vrapca gjere te lagja Latifi)	100,000	100,000	100,000
37	Ndërtimi i rruges nga lagja Rrustemeve, Qafa, Rexhe Cubi dhe Shijaku	150,000	150,000	150,000
38	Ndërtimi i rruges ne Vranjevç 300 m rruga "Dashko Shkrelli"	150,000	150,000	150,000
	Totali	11,739,188	12,629,817	14,432,643

Drejtoria e Menaxhimit të Parqeve

Drejtoria e Menaxhimit të Parqeve kryejnë këto detyra:

- Bashkëpunon ngushtë dhe raporton për punën e vetë te Kryetari i Komunës;
- Planifikon dhe menaxhon me investimet kapitale në parqe dhe hapësira publike;
- Siguron mirëmbajtjen e parqeve, hapësirave publike dhe varrezave;
- Ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligjet tjera, statut dhe aktet nënligjore të deleguara nga pushteti qendror.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	10,000	10,000	10,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione			
5	Investime kapitale	3,020,000	3,920,000	4,120,000
	GJITHSEJ:	3,030,000	3,930,000	4,130,000
	Stafi	5	5	5
	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Furnizimi me fidanë për hapësirat e qytetit dhe parqet (Pyllëzimi urban).	200,000	200,000	200,000
2	Furnizimi me lule dekorative shumëvjeçare.	20,000	20,000	20,000
3	Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese të qytetit.	1,500,000	2,000,000	2,000,000
4	Shtirja e sistemit të ujitjes në parqet e komunës së Prishtinës.	200,000	200,000	200,000
5	Mirëmbajtja e këndeve publike të lodrave.	100,000	100,000	100,000
6	Ndërtimi i parqeve në territorin e komunës së Prishtinës.	1,000,000	1,400,000	1,600,000
	Totali	3,020,000	3,920,000	4,120,000

Drejtoria e Sportit dhe Rekreacionit

Drejtoria e Sportit dhe Rekreacionit kryejnë këto detyra:

- Bashkëpunon ngushtë dhe për punën e vetë i raporton Kryetarit të Komunës;
- Harton planin për mbështetjen sportive dhe rinore;
- Udhëheq me resurset lokale rinore dhe sportive;
- Udhëheq me terrenet e sporteve dhe hapësirat tjera përcjellëse;
- Organizon debate për zhvillim dhe avancim e rinisë dhe sportit;
- Grumbullon shënime faktike mbi të arriturat në rini dhe sport;
- Bashkëpunon me nivelin qendror në fushëveprimtarinë përkatëse dhe këshilltarët nga këto fusha;

- Bën regjistrimin e grupeve, klubeve etj.;
- Mbështet aktiviteteteve rinore dhe sportive;
- Bashkëpunon me qytete tjera, për të mundur një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash me organizata të tjera vendore e ndërkombëtare;
- Përkrahë dhe ndihmon asociacione, klube dhe shoqata në aktivitetet e tyre;
- Organizon anketa, seminare e trajnime të ndryshme, kyçje të rinjve kosovarë në aktualitete rinore, evropiane e botërore;
- Ushtron edhe kompetenca të tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror.

	Kategoritë ekonomike	2022	2023	2024
1	Paga dhe mëditje	30,000	30,000	30,000
2	Mallra dhe shërbime			
3	Shpenzime komunale			
4	Subvencione	800,000	800,000	800,000
5	Investime kapitale	2,010,000	2,010,000	3,510,000
	GJITHSEJ:	2,840,000	2,840,000	4,340,000

	Stafi	5	5	5
--	--------------	----------	----------	----------

	Projektet e Investimeve kapitale	2022	2023	2024
1	Ndërtimi i fushave sportive në komunën e Prishtinës (1. Fusha e sportit - Hajvali)	310,000	310,000	310,000
2	Ndërtimi i këndeve të lodrave në komunën e Prishtinës. (Dardani, te "Elita", Dardani)	200,000	250,000	250,000
3	Ndërtimi i fushës së minigolfit (në Pishinën e Gërmisë, pjesa lindore).	50,000	50,000	50,000
4	Rregullimi dhe renovimi i terreneve sportive në komunën e Prishtinës(Fusha e futbollit)	100,000	100,000	100,000
5	Rregullimi dhe renovimi i amfiteatrit në Pishinën e Gërmisë.	150,000	100,000	100,000
6	Ndërtimi i tribunës lindore në stadiumin "2 Korriku".	200,000	200,000	200,000
7	Ndërtimi i sallës universale.	1,000,000	1,000,000	2,500,000
	Totali	2,010,000	2,010,000	3,510,000